



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1194 prot.

Tiranë, më 30. 12. 2016

Lënda: Dërgohet Rekomandimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me situatën e fëmijëve rom/egjiptian në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër.

Drejtuar: **Z. Blendi KLOSI**
Ministër
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Znj. Etleva BISHA
Drejtore e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror

Z. Erion Veliaj
Kryetar
Bashkia Tiranë

Z. Agron KAPLLANAJ
Kryetar
Bashkia Mallakastër

Z. Vangjush DAKO
Kryetar
Bashkia Durrës

Z. Xhelal MZIU
Kryetar
Bashkia Kamëz

Znj. Voltana ADEMI
Kryetare
Bashkia Shkodër



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Z. Gëzim MAHMUDAJ
Drejtor
Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur një informacion, i cili ka marrë numër 74 rregj., datë 22.07.2016, e bërë nga Qendra Evropiane për të Drejtat Rome (ERRC), Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) kundër Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimit Social Shtetëror, Bashkisë Tiranë, Bashkisë Mallakastër, Bashkisë Durrës, Bashkisë Kamëz, Bashkisë Shkodër dhe Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Racës, ngjyrës dhe etnisë”.

Referuar informacionit të dhënë nga Qendra Evropiane për të Drejtat Rome (ERRC), Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është vënë në dijeni se: “...numri total i fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër është 34. Nga këta 13 janë fëmijë romë dhe 7 janë fëmijë egjiptianë. Pra, në total numri i fëmijëve romë dhe egjiptian në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër është 20 ose 58.8 % të totalit të fëmijëve. 20 fëmijët e vendosur në këtë institucion janë fëmijë që vijnë nga familje romë dhe egjiptiane, kryesisht për shkak të problemeve sociale. Këta fëmijë romë dhe egjiptian vijnë nga bashkitë dhe njësitë administrative si vijon: Njësia Administrative nr. 6, Njësia Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Durrës, Bashkia Kamëz, Bashkia Shkodër. Nga fëmijët e sistemuar në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër, nuk është kthyer asnjë fëmijë romë dhe egjiptian në familjen biologjike gjatë vitit 2014 dhe 2015. Nga fëmijët e sistemuar në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër, nuk rezulton asnjë fëmijë romë dhe egjiptian për të cilin të jetë ofruar përkujdesja alternative e familjes kujdestare në vitet 2013, 2014 dhe 2015. Nuk rezulton asnjë fëmijë romë dhe egjiptian i birësuar në vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Informacioni fokusohet në dy çështje:

Së pari, me veprime dhe mosveprime, autoritetet përgjegjëse nuk kanë mundur të marrin masa pozitive për parandalimin e institucionalizimit. Pavarësisht qëllimit të rritjes së fëmijëve në mirëqenie materiale dhe mbrojtjes së tyre, ka realizuar një mbipërfaqësim i fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptian në këtë institucion. Përqindja 58.8 % tregon një mbipërfaqësim të fëmijëve të komunitetit romë në Shqipëri dhe numrin e popullsisë romë dhe egjiptiane në Shkodër dhe qarqe të tjera nga vijnë fëmijët romë dhe egjiptian, të sistemuar në këtë institucion. Institucionalizimi sjell efekte të dëmshme në zhvillimin e fëmijëve. Efektet e dëmshme të institucionalizimit konfirmuar nga studime të ndryshme, në rastin e një mbipërfaqësimi të fëmijëve romë dhe egjiptian, sjellin efekte të një diskriminimi të tërthortë sidomos mbi fëmijët e



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

këtyre komuniteteve. Megjithëse, në disa nga rastet janë familjet ato që kanë bërë kërkesë për të vendosur fëmijët në institucion, sepse nuk kanë mundësi t'i rrimin dhe t'u ofrojnë mirëqenien materiale për ta, kjo nuk është një zgjedhje reale e tyre, në kushtet kur pushteti vendor, bashkitë, njësitë administrative nga vijnë fëmijët nuk kanë arritur fuqizimin e familjeve.

Së dyti, nuk është mundësuar kthimi i fëmijëve rom dhe egjiptian në familjen biologjike, gjatë vitit 2015. ERRC është informuar se asnjë fëmijë rom dhe egjiptian nuk është kthyer në familjen biologjike gjatë vitit 2015. Në lidhje me numrin total të fëmijëve të kthyer në familjen biologjike gjatë vitit 2015, jemi informuar se numri i fëmijëve të kthyer në familjen biologjike është 5. Asnjë fëmijë i akomoduar në këtë institucion nuk ka kaluar në një familje kujdestare gjatë vitit 2015. Edhe gjatë vitit 2014 nuk është kthyer asnjë fëmijë rom dhe egjiptian në familjen biologjike. Në 2.5 muajt e parë të vitit 2016 janë kthyer vetëm dy fëmijë jo rom/jo egjiptian në familjen biologjike. Pra, bazuar në të dhënat zyrtare që kemi, janë kthyer 7 fëmijë jo rom dhe jo egjiptian në familjen biologjike dhe asnjë fëmijë rom dhe egjiptian, për periudhën janar 2014-mars 2016. Me mosveprimet e tyre autoritetet nuk kanë përmbushur përgjegjësitë për fuqizimin e familjeve duke kontribuar në këtë mbi përfaqësim dhe duke shkelur të drejtat e fëmijëve.

Kjo situatë përbën diskriminim të tërthortë mbi fëmijët rom dhe egjiptian në lidhje me gëzimin e të drejtës për jetë familjare dhe të drejtave të tjera të fëmijës, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.”

Sa më sipër:

- Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në Raportin¹ e Vitit 2016 për Shqipërinë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, sidomos për sa i përket strehimit të komunitetit ROM, në Shqipëri.
- Mbështetur në nenin 32, gërma f), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht **kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin**, si dhe duke patur si qëllim në vetëvete mirëbesimin dhe krijimin e marrëdhënies sa më normale, të mbështetura në parimin e barazisë dhe aspak diskriminuese, ndërmjet Komunitetit Rom dhe institucioneve shtetërore,

¹ Pika 2.4 “Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve”



Në analizë të situatës në të cilën ndodhen fëmijët dhe familjet e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi :

REKOMANDON :

1. Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për kontrollin dhe monitorimin periodik të respektimit të standardeve të shërbimeve shoqërore në institucionet rezidenciale për fëmijë, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.
2. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Tiranë, në respektim të jetës familjare të fëmijëve të cilët janë pjesë e kësaj njësie vendore, për krijimin e mundësive për fuqizimin e familjeve biologjike ose mbështetjen financiare për zhvillimin e takimeve më të shpeshta të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër me familjarët e tyre.
3. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Kamëz, në respektim të jetës familjare të fëmijëve të cilët janë pjesë e kësaj njësie vendore, për krijimin e mundësive për fuqizimin e familjeve biologjike ose mbështetjen financiare për zhvillimin e takimeve më të shpeshta të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër me familjarët e tyre.
4. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Durrës, në respektim të jetës familjare të fëmijëve të cilët janë pjesë e kësaj njësie vendore, për krijimin e mundësive për fuqizimin e familjeve biologjike ose mbështetjen financiare për zhvillimin e takimeve më të shpeshta të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër me familjarët e tyre.
5. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Mallakastër, në respektim të jetës familjare të fëmijëve të cilët janë pjesë e kësaj njësie vendore, për krijimin e mundësive për fuqizimin e familjeve biologjike ose mbështetjen financiare për zhvillimin e takimeve më të shpeshta të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër me familjarët e tyre.
6. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Shkodër, në respektim të jetës familjare të fëmijëve, për krijimin e mundësive për fuqizimin e familjeve biologjike ose mbështetjen financiare për zhvillimin e takimeve më të shpeshta të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër me familjarët e tyre.
7. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër, në respektim të jetës familjare të fëmijëve të rrisë bashkëpunimin me njësitë vendore nga të cilat vijnë fëmijët, me qëllim që të zbatojnë planin e rrugës për të ardhmen dhe kthimin e fëmijës përkohësisht apo përfundimisht në një familje biologjike.

Për sa më sipër, shpresojmë dhe besojmë në një bashkëpunim sa më të frytshëm ndërmjet institucioneve tona në të ardhmen, duke e vlerësuar maksimalisht mirëkuptimin Tuaj, në mënyrë që institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kryejë detyrat e tij funksionale, në mënyrë sa më korrekte dhe konform ligjeve dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Konceptoi: R. Babaj

Pranoi: V. Bushati

Date: 24.10.2016



Adresa: Rruga Sami Frasherit, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al